

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi

Zgjerojmë dhe
shkallëzojmë
ndikimin tonë



Mesazh nga ambasadorja e SHBA-së në Shqipëri, Yuri Kim

Të dashur vullnetarë, pjesëtarë të stafit, partnerë dhe mbështetës të Korpusit të Paqes,

Kam kënaqësinë të vlerësoj arritjet e Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mal i Zi. Urime vullnetarëve që kontribuuan në shumë mënyra së bashku me homologët e tyre shqiptarë, për t'i bërë komunitetet më të forta, më të shëndetshme dhe më të fuqizuara.

Vullnetarët e Korpusit të Paqes janë drejtues në diplomacinë qytetare. Ata janë të përkushtuar dhe të përqendruar në punën e tyre në Shqipëri; fuqizimin e miqësisë shqiptaro-amerikane. Unë e mbaj me krenari titullin e ambasadores. Gjithashtu, unë jam krenare për ekipin tonë të madh, duke pranuar se të gjithë ne që punojmë për të forcuar lidhjet shqiptaro-amerikane këtu jemi ambasadorë në këtë vend.

Në nëntor të vitit 2019, Shqipërinë e goditi një tërmet shkatërrimtar. Vullnetarët e Korpusit të Paqes u bashkuan me ekipin e Shteteve të Bashkuara dhe u hodhën në veprim së bashku me homologët e tyre shqiptarë, psikologë, OJQ-të dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Brenda javës, vullnetarët tanë organizuan një Trajnim për Trajnuesit. Duke bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve ata zhvilluan trajnimin në tri bashkitë më të prekura në Tiranë, Durrës dhe Lezhë e më pas në të gjithë vendin. Vullnetarët dhe homologët e tyre mbuluan një shifër impresionuese prej 900 shkollash dhe mbi 5000 mësues. Fuqia dhe ndikimi i punës së vullnetarëve tanë kurorëzohet në këtë përpjekje mbresëlënëse.

Gjatë jetës sime kam pasur mundësinë të kuptoj fuqinë e Korpusit të Paqes.

Falë origjinës sime nga Korea e Jugut, kam pasur mundësi të dëshmoj përfitimet e pabesueshme dhe rezultatet e arrira nga një grup i jashtëzakonshëm amerikanësh që angazhohen për të shërbyer për dy vite në Korpusin e Paqes. Shoh të njëjtin ndikim në Shqipëri. Mbi gjithë të tjerat, vullnetarët e Korpusit të Paqes sjellin shpresë dhe risi.

Unë kam kënaqësinë të shërbej si ambasadore e një vendi me vullnetarë kaq të talentuar që mishërojnë më të mirën e Amerikës nëpërmjet përkushtimit që kanë ndaj misionit të tyre për paqen në botë dhe miqësinë

Sinqerisht juaja,

Yuri Kim



Mesazh nga ambasadorja e SHBA-së në Mal të Zi, Judy Rising Reinke

Të dashur miq, partnerë dhe kolegë,

Korpusi i Paqes është një institucion amerikan i dashur. Për më shumë se 60 vjet, vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë shërbyer në shumë shtete në të gjithë botën. Ndonëse kohët kanë ndryshuar që nga themelimi i tij nga presidenti Kennedy në 1961-in, misioni i Korpusit të Paqes për të promovuar *paqen në botë dhe miqësinë* nuk ka ndryshuar.

Viti i kaluar ishte një moment historik për ambasadën tonë dhe marrëdhënien tonë bilaterale, kur ne së bashku me partnerët tanë malazezë dhe kolegët e Korpusit të Paqes, lehtësuam nënshkrimin e Marrëveshjes Bilaterale midis Shteteve të Bashkuara dhe Malit të Zi duke lançuar zyrtarisht zanafillën e Korpusit të Paqes në Malin e Zi!

Grupi i parë i vullnetarëve arriti nga Shtetet e Bashkuara në janar të vitit 2020. Ata kanë privilegjin dhe përgjegjësinë e madhe të hedhin themelet e këtij kapitull të ri në marrëdhënien tonë. Mezi po e pres ditën kur, Vullnetarët e Korpusit të Paqes do të shërbejnë në shkollat malazeze, do të japin mësim në anglisht përkrah homologëve malazezë dhe do të punojnë me rininë malazeze për të gjetur mënyrat për të sjellë ndryshimin në komunitetet ku ata shërbejnë.

Shërbimi dhe jetesa në Malin e Zi midis vendasve do të ndryshojë jetën e këtyre vullnetarëve. Veçanërisht, ata do të kuptojnë kulturën malazeze teksa jetojnë dhe punojnë përkrah qytetarëve të këtij vendi të mrekullueshëm, në të cilin jam krenar të shërbej si ambasadore e Shteteve të Bashkuara.

Gjithashtu, do të doja të ndaja vlerësimin tim të madh dhe mirënjohjen për mikpritjen e ngrohtë të familjeve malazeze që kanë hapur shtëpitë dhe zemrat e tyre vullnetarëve tanë. Mikpritja juaj është kuptimplotë për vullnetarët, teksa angazhohen me një shërbim 2-vjeçar në Malin e Zi.

Prania e Korpusit të Paqes në Mal të Zi vërtet është një fitore për të dy vendet tona dhe unë nuk do mund të isha më e emocionuar për fillimin e këtij partneriteti të rëndësishëm.

Sinqerisht,

Judy Rising Reinke

Ambasadorja e SHBA ne Mal të Zi



Mesazh nga Drejtoresha për Shqipërinë dhe Malin e Zi Kate Becker

Përsëndetje,

2019 ka qenë një tjetër vit shumë i rëndësishëm për ne. Ka qenë viti i rritjes dhe shtrirjes së ndikimit tonë. Arsyeja e gjithçkaje që bëjmë mbeten të rinjtë. Mënyra si e arrijmë i detyrohet marrëdhënieve njerëzore. Çfarë bëjmë varion nga reagimi i menjëhershëm dhe i rëndësishëm ndaj tërmetit me mësimdhënien e përditshme në shkolla, duke frymëzuar fëmijët të kenë ëndrra të mëdha dhe duke bërë tifo për kauza të rëndësishme për komunitetet, teksa ata përpiqen për të bërë më të mirën. Në 2019 ne e rritëm më shumë ndikimin tonë duke vazhduar të prekim një numër gjithnjë e më të madh komunitetesh në Shqipëri tek të cilët nuk kishin pasur më parë vullnetarë të Korpusit të Paqes. Ne shtrimë më tej ndikimin tonë duke iu përgjigjur krizës në shkallë kombëtare pa pasur një plan të parapërgatitur. Vullnetarët punuan përkrah drejtuesve vendas ndërkohë që:

Jepnin mësim dhe frymëzonin. Në klasë, jashtë klase, në kampe verore dhe në programe të veçanta si Write On, Model UN e më shumë të tjera. Nga mbulimi i pesë fshatrave nga Jerry te muralet e Layla-ës dhe iniciativat të bazuara te të rinjtë në shkolla.

Krijimi i programeve për fuqizimin e grave dhe mundësive ekonomike si punishtja organike e verës e Ryan-it e bazuar në Fushë Arrëz e kooperativa e Jillian në Pukë ku bëhen qirinj;

Bashkëpunimet e ngritura nëpërmjet institucioneve të rëndësishme vendore si partneriteti i Derek-ut me zyrën vendore të arsimit për të zhvilluar orë mësimore në anglisht dhe trajnime për zhvillimin profesional të mësuesve të shkollave filllore dhe të lëndës së shkencës dhe iniciativa e Carolyn-ës për edukimin shëndetësor me Qendrën Shëndetësore dhe shkollat; dheu hodhën në aksion duke reaguar ndaj tërmetit 6.4 ballë;

Gjashtë vullnetarë, Jared, Stacey, Felix, Katie, Carolyn dhe Colin zhvilluan një kurrikulë së bashku me Qendrën e Marrëdhënive dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

45 vullnetarë së bashku me homologët në komunitet dhe World Connect zhvilluan 129 trajnime në 52 komunitete, duke edukuar 2347 mësues nga 897 shkolla në një hark kohor prej 50 ditësh.

3 vullnetarë Stacey, Katie dhe Aceem mbështetën World Central Kitchen me përgatitjen dhe shpërndarjen e më shumë se 72,000 vakteve për njerëzit në nevojë.

Ne jemi krenarë që kemi shtrirë ndikimin tonë duke hartuar planin dhe infrastrukturën dhe duke zbatuar Korpusin e Paqes në Malin e Zi. Falënderojmë Qeverinë e Malit të Zi dhe Ambasadën Amerikanë për krijimin e kësaj mundësie të përbashkët dhe falënderojmë veçanërisht familjet dhe shkollat që kanë bërë investimin e tyre për fëmijët e tyre duke u bërë të parët që hapën shtëpitë e tyre dhe mikpritën vullnetarët tanë.

Ne po rrisim dhe shtrijmë ndikimin tonë në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ju, palët e interesuara që po e lexoni këtë, bëni të gjithë ndryshimin në atë që bëjmë së bashku.

Kate M. Becker

Drejtoresha Vendore e Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi



Drejtoresha e Korpusit të Paqes Jody Olsen dhe Drejtoresha Vendore Kate Becker duke parë liqenin e Shkodrës nga ana malazeze.

Misioni dhe Objektivat e Korpusit të Paqes

- Në 1961, presidenti John F. Kennedy themeloi Korpusin e Paqes për të nxitur mirëkuptim më të mirë dhe për të promovuar miqësinë ndërmjet amerikanëve dhe popujve të tjerë.
- Misioni i Korpusit të Paqes është të promovojë paqen në botë dhe miqësinë duke përbushur tri objektiva:
- Të ndihmojë popullsinë e shteteve të interesuara të përbushin nevojat e tyre për burra dhe gra të aftësuar.
- Të ndihmojë në promovimin e një mirëkuptimi më të mirë të amerikanëve nga ana popujve që i shërbejnë.
- Të ndihmojë në promovimin e një mirëkuptimi më të mirë të popujve të tjerë nga amerikanët.
- Korpusi i Paqes ndryshon jetën; jetën e njerëzve në komunitetet në të gjithë botën dhe jetën e vullnetarëve.
- Më shumë se 235,000 amerikanë kanë shërbyer në Korpusin e Paqes në 142 shtete.



Korpusi i Paqes në Shqipëri

- Në vitin 1991, qeveria Shqiptare ftoi SHBA-në të hapë një program të Korpusit të Paqes në vend. Grupi i parë i vullnetarëve arriti në Shqipëri në 1992, të angazhuar për mësimdhënien e gjuhës Angleze në shkolla të ciklit të dytë dhe në universitete. Nga viti 1993 deri në vitin 1996 katër grupe të tjera vullnetarësh mbërritën për të dhënë mësim në anglisht, për të mbështetur zhvillimin e biznesit të vogël ose për të mbështetur menaxhimin e bujqësisë dhe pyjeve. Korpusi i Paqes mbylli programin e tij në Shqipëri në 1997 për shkak të trazirave politike dhe shqetësimeve për sigurinë e vullnetarëve.
- Qeveria shqiptare ftoi Korpusin e Paqes të ri-hapë programin e tij në vitin 2002 dhe mori pjesë në një vlerësim të zhvilluar nga Korpusi i Paqes. Bazuar në këtë vlerësim, anëtarët e parë të Korpusit të Paqes mbërritën në mars të vitit 2003 dhe ngritën një zyrë dhe ri-hapën programet.
- Që nga shtatori i vitit 2003, vullnetarët kanë punuar me qeveritë vendore, OJQ-të, shkollat dhe institucionet shëndetësore në tre fusha:
 - Arsimi në anglisht
 - Edukimi shëndetësor
 - Zhvillimi i komunitetit dhe organizatave.
- Programi i Korpusit të Paqes është i pranishëm në Shqipëri me ftesë të qeverisë shqiptare dhe operon sipas një marrëveshjeje midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë që njeh rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve me avantazhe reciproke dhe bashkëpunimit.
- Që nga shtatori i vitit 1992, 900 vullnetarë kanë punuar në Shqipëri.



Shtrirja e ndikimit tonë: Mali i Zi bëhet shteti i 142-të që merr shërbim nga Korpusi i Paqes



Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit—Në qershor të vitit 2019 Korpusi i Paqes nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit me Ministrinë e Arsimit të Malit të Zi.

Aktivitetet—Përkrah homologëve mësues, vullnetarët do të japin mësim për gjuhën angleze në shkollat fillore dhe nëntëvjeçare. Ata do të përqendrohen në metodologjinë e mësimdhënies për përmirësimin e aftësive në gjuhën angleze. Gjithashtu, ata do të japin ndihmën e tyre në projektet shkollore verore me të rinjtë dhe komunitetet ku jetojnë dhe shërbejnë.

Ndikimi— Kjo i hap rrugën një mundësie shumë të mirë që mësuesit e gjuhës angleze, që janë vullnetarë për Korpusin e Paqes, të bashkëpunojnë me shkollat në Malin e Zi dhe nxënësit malazezë që të mësojnë anglisht nga amerikanë dhe të kuptojnë më mirë amerikanët. Gjithashtu, duke jetuar përkrah komuniteteve të cilave do t'u shërbejnë, vullnetarët do të mësojnë të vlerësojnë kulturën malazeze.

Ministri i Arsimit të Malit të Zi Damir Šehovic drejtoresha Vendore e Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi Kate Becker, në ceremoninë e nënshkrimit më 19 qershor 2019

GUSHT
2018

Kryeministri malazez fton Korpusin e Paqes të hapë një program në Malin e Zi

MAJ
2019

Shtetet e Bashkuara dhe qeveria e Malit të Zi nënshkruajnë Marrëveshjen Bilaterale

QERSHOR
2019

JANAR
2020

Grupi i parë i të trajnuarve të Korpusit të Paqes ka mbërritur në vend për të filluar trajnimin gjatë përgatitjes për shërbimin e tyre dy-vjeçar.

Korpusi i Paqes Shqipëri ndryshon dhe bëhet Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mal i Zi

Korpusi i Paqes shpalli në vitin 2019 planet e tij për të hapur një program të ri në Mal të Zi të përqendruar në arsimin në anglisht. Mali i Zi do të jetë vendi i 142-të për të cilin agjencia do të shërbejë dhe do të drejtohet nga Korpusi i Paqes në Tiranë, Shqipëri së bashku me një zyrë të vogël në Podgoricë, Mal të Zi. Si rezultat, Korpusi i Paqes në Shqipëri ka ndryshuar emrin në Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mal të Zi më 23 gusht 2019.



Fakte të shpejta: Vullnetarja e Korpusit të Paqes, Malia (2017-2019) ndikoi në lançimin e Korpusit të Paqes në Malin e Zi. Mamaja e saj, Margaret Uyehara, ishte ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Malin e Zi dhe ajo ishte shumë e impresionuar nga ndikimi që Malia kishte me shërbimin e saj dhe ndikimin që ky shërbim kishte te ajo. Ambasadorja Uyehara, pasardhësja e saj ambasadorja Reinke, së bashku me Judy Kuo, Jeff Adler, Jelena Vojnic, Bernard Cobaj, ishin ndër kampionët e parë dhe kishin rol kritik në kthimin e Korpusit të Paqes në Mal të Zi në realitet.

Prezantimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes: Nga jemi

Vullnetarët e Korpusit të Paqes vijnë nga të gjitha anët e Shteteve të Bashkuara për të sjellë ndryshime në nivelin më bazë në Shqipëri. Vullnetarët ndajnë vlerat e perspektivat e qyteteve të tyre të lindjes me komunitetet mikpritëse ku shërbejnë. Amerika ndan burimin e saj më të çmuar-njerëzit e saj, për të krijuar një shkëmbim ndërkulturor të paqes dhe miqësisë.



“Gjëja më e rëndësishme që kam mësuar nga Laila është që mësimdhënia nuk realizohet dhe nuk duhet të realizohet vetëm siç na kanë mësuar në universitete. Mësimdhënia fillon në klasë dhe përforcohet jashtë mureve të klasës, ku unë dhe Laila ishim një me nxënësit tanë dhe kemi kuptuar që të gjithë ne së bashku mund të arrinim edhe të pamundurën.”


*Zheni,
Homologia e vullnetares
Laila
Counterpart*

Prezantimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes

MOSHA KUR KANË ARRITUR NË SHQIPËRI

Tani më shumë se kurrë ndihem se është absolutisht e rëndësishme për Shqipërinë të trajnojë dhe kualifikojë të rinjtë e saj. Mentorimi i sipërmarrësve të rinj socialë që i rezistojnë joshjes për t'u larguar drejt Tiranës ose jashtë vendit, por që identifikojnë dhe krijojnë mundësi për veten dhe të tjerët në komunitete rurale dhe komunitetet në qytete të vogla është vërtet frymëzues. Pa diskutim, të jesh pjesë e këtij udhëtimi dhe t'i shohësh të rriten si individë, drejtues dhe agjentë për ndryshimin pozitiv ka qenë një nder i madh dhe pika kulmore e shërbimit tim.

*Derek, vullnetar
Shqipëria e Jugut*



2

Vullnetarë janë
bërë shtetas të
SHBA-së për t'iu
bashkuar
Korpusit të Paqes

3


Vullnetarët kishin shërbyer si vullnetarë të Korpusit të Paqes më parë!

ARSIMI



(100%)
(11%)
(17%)
(6%)
(1%)

Prezantimi i vullnetarëve të Korpusit të Paqes të vitit 2019



Gjuhët

Anglishtja nuk është gjuha amtare e 10% e të anketuarve

54% e të anketuarve* Flasin 1 gjuhë tjetër përveç anglishtes dhe

8 nga të anketuarit* flasin 2 gjuhë të tjera
1 nga të anketuarit* flet 4 gjuhë të tjera

e të anketuarve* me një pjesëtar të familjes ose mik që kishte qenë ose është vullnetar i Korpusit të Paqes


- Vëllezër/Motra 1
- Kushërinj 1
- Miq ose kolegë të ngushtë 25

Prezantimi i vullnetarëve të Korpusit të Paqes në vitin 2019

Pas shërbimit në Korpusin e Paqes, si planifikojnë vullnetarët që të vazhdojnë të ruajnë idealet e Korpusit të Paqes.


“Sesione pas traumës së tërmetit që bëme për shkollat patën shumë ndikim te mësuesit. Unë dëshmoja se si mësuesit patën mundësinë që për herë të parë të kalonin hidhërimin me të cilin po përballeshin. Ata kishin punuar aq fort për t’u siguruar që familjet dhe nxënësit e tyre të ndiheshin të sigurtë, të cilët nuk kishin pasur mundësinë të shprehen; asgjë nga këto nuk do të kishte qenë e mundur pa mbështetjen e psikologëve lokalë që shpenzuan kohën e tyre për të na ndihmuar.

Vullnetari Colin, punoi në zonat e prekura nga tërmeti në Shqipëri



Prezantimi i vullnetarëve të Korpusit të Paqes në vitin 2019

Përveç se tregojmë kulturën e Shqipërisë nëpërmjet historive, si planifikojnë vullnetarët të tregojnë Shqipërinë amerikanëve kur të kthehen në shtëpitë e tyre?



- Duke ndarë muzikën, filmat dhe kulturën shqiptare me miqtë dhe familjen; duke shkruar blogje ose artikuj për Shqipërinë
- Duke bashkuar Miqve të Shqipërisë ose grupeve të tjera VKKP (Vullnetarëve të kthyer të Korpusit të Paqes)
- Të tjera, përfshirë organizimin e diskutimeve në shkolla dhe eventeve të tjera që kanë në qendër festat shqiptare

“Marrëdhënia ime me familjen që më mirëpriti është pjesa parësore e shërbimit tim. Familja që më mirëpriti më ka prezantuar me Traditën në fshatin tim dhe situata të jetës së përditshme me të cilat njerëzit përballen. Ata më treguan një perspektivë më të gjerë gjatë shërbimit tim dhe më bënë të ndihem e përfshirë në familjen e tyre.”

Laura, vullnetare, Bicaj, Kukës

Objektivat e 2019-ës sipas sektorit: Shtrirja e ndikimit tonë

Edukimi shëndetësor

1. Shëndeti seksual dhe riprodhues Të rinjtë do të përvetësojnë sjellje dhe praktika që kontribuojnë në përmirësimin e shëndetit seksual dhe riprodhues

2. Stil jetese të shëndetshëm dhe Aftësi për Jetën

Të rinjtë do të zhvillojnë aftësitë e nevojshme në jetë për të marrë vendime të përgjegjshme dhe të shëndetshme si dhe të marrin vendime që do të ndikojnë jetët e tyre dhe të atyre përreth.



Zhvillimi i komunitetit dhe organizatave

1: Zhvillimi i organizatave

Organizatave vendase dhe grupet e komunitetit do të forcojnë aftësitë e tyre menaxhuese/operative dhe organizative, si edhe do të njihen me proceset.

2. Ndërtimi i shoqërisë civile

Individët do të rrisin kapacitetin e tyre për të marrë pjesë në zhvillimin e qeverisë civile lokale dhe komunitetit.

Arsimi në anglisht

1. Përmirësimi i mësimdhënies

Mësuesit dhe instruktorët e anglishtes do të përmirësojnë zotërimin e tyre të anglishtes, metodat e mësimdhënies dhe aftësitë e zhvillimit të burimeve.

2. Rritja e suksesit të nxënësve

Nxënësit do të përmirësojnë aftësitë e tyre në anglisht, komunikim dhe aftësitë në jetë, nëpërmjet udhëzimeve në anglisht në klasë dhe nëpërmjet aktiviteteve ekstrakurrikulare.

3. Forcimi i shkollës dhe komunitetit

Mësuesit, stafi i shkollës dhe administratorët, pjesëtarët e komunitetit të gjerë do të forcojnë bashkëpunimin dhe do të jenë pjesëmarrës më aktivë dhe drejtues të komunitetit të shkollës së tyre.

Rritja e ndikimit: Një fjalor i veçantë i një gjuhe minoritare të folur në Shqipëri

Zhvillimi i komunitetit dhe organizatave—Shqipëria është shtëpia e shumë pjesëtarëve të komunitetit rom. Vullnetarja e zhvillimit të organizatave në komunitet, Katie, pranoi nevojën që vullnetarët që shërbejnë në Shqipëri të kuptojnë gjuhën rome përveç shqipes.

Aktivitetet—Katie propozoi idenë e një fjalori Shqip/Romani një OJQ-je, “Roma Gate for Integration”. Pas disa diskutimesh dhe kërkimesh ata thanë “Poteqe Paslla!” (Le ta bëjmë!) dhe ndihmuan në krijimin një fjalorthi me fjalë dhe fraza rome të përdorura në të dyja komunitetet. Pas një pune të vështirë përfundoi fjalorthi romani-anglisht-shqip.

Ndikimi—Thyerja e barrierave nëpërmjet komunikimit. Për të kremtuar ditën e Romëve në 2019-ën, Katie dhe Fatmira, homologa e saj, punuan për të krijuar mundësinë që gratë rome t’i mësojnë disa fraza në gjuhën rome vullnetarëve të rinj nga gjimnazet në të gjithë rajonin. Fjalori iu shpërnda dhe Vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe do të përdoret në trajnime të mëtejshme. Fjalori do të bëhet urë për tri komunitete- atë shqiptar, rom dhe amerikan-për të forcuar lidhjet mes tyre.



Vullnetarja e Korpusit të Paqes Katie (djathtas) me drejtuesen rome Fatmirën (majtas) dhe pjesëtarën e minoritetit rom Lubjana (në mes) gjatë projektit.

747

Individë, pjesëtarët e organizatave lokale ose komuniteteve u trajnuan në zhvillimin e organizatave (planifikimin, menaxhimin e brendshëm, menaxhimin e hartimit të projektit, komunikimin).

1476

Individë u angazhuan në ndërtimin e shoqërisë civile; drejtimi, aftësitë profesionale, të nxënimit në shërbim të shoqërisë, puna vullnetare dhe aftësi advokuese.

Rritja e ndikimit: Një mësues në udhëtim

Arsimi në anglisht— Shkolla ku vullnetari , Jerry, jep mësim quhet shkolla kolektive që do të thotë që i shërben të gjithë nxënësve të të gjitha moshave nga një rajon i gjerë. Jerry thotë se është sfiduese t'i japësh mësim fëmijëve të moshave 5-18 në një klasë të vetme. Nxënësit vijnë nga fshatrat përreth dhe duke marrë parasysh kufizimet në transport, disa prej tyre duhet të ecin për distanca të gjata për të shkuar në shkollë. Nxënësit pyetën Jerry-in nëse ai mund t'i vizitonte në fshatra gjatë verës për të vazhduar t'i jepte mësim në anglisht. Ai pranoi dhe bëri pikërisht këtë!

Aktivitete— 113 nga nxënësit jetojnë në 6 fshatrat rreth komunitetit të Jerry-it ku ndodhet shkolla. Jerry hartoi një program dhe disa ditë iu desh të ecte 7 milje (11.3 km) vajtje-ardhje për të arritur te të gjithë nxënësit gjatë verës.

Ndikimi— Shikimi në fytyrat e tyre kur ai arrinte në fshatin e tyre vllente sa për të gjithë kilometrat që Jerry përshkonte për t'i mësuar anglisht. Ata thonë se mësuesi i tyre është i mrekullueshëm. Përveçse u ndien të frymëzuar nga angazhimi i tij, anglishtja fëmijëve vazhdoi të përmirësohej edhe në verë!



Duke parë interesin e nxënësve, mësuesi vullnetar i Korpusit të Paqes Jerry, i krijoi mundësinë të vazhdonin mësimet në anglisht duke dhënë orë mësimi edhe gjatë verës.

- 275** Mësues u angazhuan në bashkë-mësimdhënie dhe planifikim, në krijimin e burimeve, krijimin klasave për nxënësit me aftësi ndryshe dhe librarive.
- 8487** Nxënës mësuan anglisht në klasë dhe rritën pjesëmarrjen e tyre në aktivitete ekstrakurrikulare.
- 610** Pjesëtarë të komunitetit u angazhuan në aktivitete dhe projekte të zhvillimit profesional dhe personal.

Rritja e ndikimit: Një qasje e re ndaj advokimit për edukimin shëndetësor

Edukimi shëndetësor—Neda, një vullnetare e Edukimit shëndetësor, që punon në veri të Shqipërisë, ka siguruar mbështetje të drejtpërdrejtë për restorantet vendase në një projekt më të gjerë të përqendruar te turizmi. Neda e ka përqendruar projektin e saj në rëndësinë e higjienës dhe edukimit stafit të restorantit në lidhje me përgatitjen e ushqimit dhe shpërndarjen në restorante dhe kafene.

Aktivite—Neda bashkëpunoi me pronarët e restoranteve dhe krijuan postera në shqip. Posterat shërbyen si kujtesë vizuale për të gjithë stafin e restorantit për rëndësinë e higjienës në restorante. Posterat ishin pjesë e një iniciative trajnimit. Një projekt i mëvonshëm kishte qëllim të ndihmonte pronarët e restoranteve të zhvillonin versionin anglisht të menyve të tyre.

Ndikimi—Ky poster është i dukshëm në shumë kuzhina dhe tualete të restoranteve në këtë komunitet. Menytë dygjuhëshe kanë përfitim ekonomik, ndihmojnë restorantet të mbështesin turizmin e shtuar në rajonin e tyre.



Ky poster së bashku me menytë dygjuhëshe u prodhua dhe u shpërnda nga vullnetarja e Korpusit të Paqes Neda në restorante dhe bare përreth komunitetit të saj.

Rritja dhe Shtrirja e ndikimit tonë

TRAJNIMI I VULLNETARËVE

Vullnetarët e Korpusit të Paqes i nënshtrohen trajnimeve gjithëpërfshirëse që fillojnë me mbërritjen e tyre dhe vazhdojnë përgjatë gjithë shërbimit të tyre.

Ndërkohë që të trajnuarit kaluan dhjetë javët e para të tyre në Trajnimin Para-Shërbimit ku ata aftësohen për gjuhën, trajnohen në aspektin ndër-kulturor dhe teknik, teksa gjithashtu mësojnë si të jenë të sigurtë dhe të shëndetshëm gjatë shërbimit të tyre.

Ata gjithashtu perfitojnë edhe nga trajnime te tjera , si: *Trajnimi Gjate Sherbimit; Seminari i Projektimit dhe Manaxhimit te Projekteve; Trajnimi i Mes Sherbimit dhe Konferenca e Mbylljes se Sherbimit*



EVENTET NË PËRFUNDIM TË SHËRBIMIT

Ceremonia e Përfundimit të Shërbimit (CPSH) është një ngjarje kulmore, ku pjesëtarët e stafit, si dhe miqtë dhe kolegët e komunitetit të vullnetarëve mund të shprehin falënderimet dhe vlerësimet e tyre për shërbimin e vullnetarëve.

Në mënyrë simbolike vullnetarët i ranë ziles së CPSH-së dhe kërkuan të vazhdonin të shërbenin dhe kontribuonin për miqësinë shqiptaro-amerikane, edhe pasi shërbimi i tyre si vullnetarë të Korpusit të Paqes të kishte mbaruar.

VIZITA E DREJTORESHËS SË KORPUSIT TË PAQES

Drejtoresha Jody Olsen ka udhëtuar drejt Malit të Zi për të nënshkruar Marrëveshjen Bilaterale në maj të vitit 2019. Si rrjedhojë në vitin 2020 ne mirëpritëm vullnetarët e Korpusit të Paqes që do të shërbejnë në Mal të Zi!

Drejtoresha Olsen e shtriu vlerësimin dhe mbështetjen e saj tek vullnetarët, kolegët e tyre shqiptarë dhe pjesëtarët shqiptarë të stafit.

Për më tepër, gjëra të mëdha u arritën në mbledhjet e saj me autoritetet shqiptare, si nënshkrimi i versionit të rinovuar Memorandumit të Mirëkuptimit me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.



"Lidhjet e miqësisë dhe marrëdhëniet që janë krijuar nga këto lidhje kanë sjellë një ndryshim që kur kam arritur në Shqipëri. Ashtu siç unë i kam treguar pasionin tim për mësimdhënien, ata më kanë treguar pasionin e tyre për të mësuar gjuhën angleze. Kështu të dyja palët kemi qenë të bekuar."
Jerry, vullnetar, zona e Beratit.

Në nëntor të vitit 2019, Shqipëria u godit nga tërmeti më i fuqishëm i dekadave të fundit— Ai pati një efekt shkatërrues mbi vendin duke lënë pas vdekje, shumë të plagosur dhe dëme shkatërruese. Gjithashtu, shumë personave, duke përfshirë edhe fëmijët, iu desh të përballeshin me traumën psikologjike.

Aktivitetet—Vullnetarët e Korpusit të Paqes në të tre sektorët dhe nga e gjithë vendi, iu bashkuan përpjekjeve të popullit shqiptar për t’u përballur me katastrofën. Pas një kërkesë nga Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me Qendrën e Marrëdhënieve dhe me financimin nga World Connect, vullnetarët hartuan një kurrikulë që i ofronte trajnimin dhe mjetet e nevojshme mësuesve që të reagonin më mirë dhe të mbështesin nxënësit e prekur nga trauma pas tërmetit.

Duke filluar 2 javë pas tërmetit, vullnetarët dhe homologët psikologë shqiptarë trajnuan mësuesit e çdo shkolle në tre qarqet më të prekura në Durrës, Lezhë dhe Tiranë. Ata e shtrinë trajnimin në të gjithë vendin duke punuar përkrah homologëve, mësuesve dhe psikologëve të shkollave.

Ndikimi—Shkollat dhe mësuesit janë më të përgatitur që të përmbushin nevojat psikologjike të fëmijëve dhe mësuesve në Tiranë, Durrës dhe Lezhë.



VKP Anna (në mes) dhe Jared (në të majtë) së bashku me homologen e tyre shqiptare Majlindën gjatë seancave të trajnimit me mësuesit e Tiranës.

Shtrirja e ndikimit: Shqipëria pas tërmetit: Ofrimi i vakteve

Më 26 nëntor, tërmeti ndryshoi jetët e këtij qarku- Shumë familje humbën shtëpitë dhe po jetonin në kushte të improvizuara. Fëmijët u zhvendosen nga shkollat. Mbështetja ishte e menjëhershme në zonat urbane, por u vonua në mbërritjen te komunitetet e zonave rurale. Ndërkohë, punonjësit e emergjencës dhe qytetarë të mirë po punonin fort për të ndihmuar fillimisht në fazat e para të përgjigjes dhe më pas gjatë rikuperimit. World Central Kitchen duke mobilizuar shefat lokalë të kuzhinës dërgoi një ekip nga Kalifornia të pozicionuar në zonë të ngrinin kuzhina të përkohshme. Por ekipet hasën vështirësi në gjetjen e një vendi për të përgatitur vaktet që ishte kryesorja dhe gjithashtu hasën vështirësi të gjenin mënyrën për t'u lidhur me banorët e vendeve më rurale dhe për t'u siguruar që ata të kishin një vakt të ngrohtë.



Aktivitete— Vullnetarët e Korpusit të Paqes pranë zonave të prekura u mbledhën për të mbështetur komunitetet e shtëpive të tyre dhe këtë qark të madh. Vullnetarët ndihmuar në koordinimin dhe furnizimin e kuzhinës, porositjen e furnizimeve, llogaritjen e çfarë nevojitej, përgatitjen e ushqimit dhe ndihmuar në rolin thelbësor asaj të lidhjes me ata që kishin nevojë dhe shpërndarjen e 72,179 vakteve.

Ndikimi—Rrjeti i mirë-ngritur i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe aftësitë e tyre gjuhësore i ndihmuar të siguroheshin që ata më në nevojë të merrnin ushqimin. Ata gjithashtu siguruan qëndrueshmërinë e projektit duke lidhur World Central Kitchen me fondacionin Food Bank Albania.



VKP Aceem, Katie dhe Stacey përgatitën ushqim për fëmijët dhe familjet e prekura nga tërmeti shkatërrimtar.

72,179

Vakte iu ofruan fëmijëve dhe pjesëtarëve të komunitetit në zonat e goditura më fort në Durrës, Lezhë dhe Tiranë, të cilat u shërbyen në 16 vendndodhje. Pezë, Pezë e Vogël, ndroq, pezë helmes, shiak, Pojan, Grecë, Gjyslkojnë, Shtrate, Eminas i vogël, , Shetël, Shahinë, Bubq.

Rritja e ndikimit: Kampe verore

Vazhdimi i mësimet gjatë verës— Verë do të thotë që nuk ka shkollë, që gjithashtu do të thotë humbja e 25-30% e çfarë është mësuar për nxënësit nga klasa e dytë në të shtatë. Vullnetarët bashkëpunuan me homologët e tyre, drejtuesit e të rinjve dhe përfaqësuesit e komunitetit për të angazhuar të rinjtë në klube jashtë-shkollore, kampe edukuese dhe iniciativa sportive gjatë vitit dhe veçanërisht përgjatë muajve të verës.

Aktivitetet—Gjatë verës së vitit 2019, vullnetarët e Korpusit të Paqes eksploruan tema të ndryshme me të rinjtë e komunitetit të tyre në kampe verore si trajnimi G.L.O.W. (Vajzat që drejtojnë botën tonë); trajnimi B.L.A.S.T. (Drejtimi i Djemve, Advokimi, dhe Mbështetja) Aftësitë për Jetën; Shëndeti dhe Mirëqenia; Drejtimi; Mendimi Kritik; Sipërmarrja dhe Biznesi; Sportet; Çështje të lidhura me Mjedisin; Aftësi në Gjuhën Angleze; Shërbim Komunitar/Punë vullnetare, etj.

Ndikimi— Këto kampe ndihmojnë të mbajnë fëmijët e angazhuar për të ulur humbjen e të nxënit dhe të sigurojnë që fëmijët të përfshihen në iniciativa të shëndetshme, produktive dhe edukative. Gjithashtu, kampet angazhojnë të rinjtë më të rritur në mundësi drejtimi që rrisin vetëbesimin e tyre dhe aftësitë që i ndihmojnë të ndërveprojnë me të tjerët duke përfshirë angazhimet civile.



Aktivitetet në Kampet Verore të Korpusit të Paqes në Delvinë, Shqipëri.

- 65** Kampe u ngritën në komunitete të ndryshme në të gjithë Shqipërinë gjatë verës së vitit 2019.
- 116** Homologë kanë kontribuar në projektimin dhe ngritjen e kampeve të organizuara nga vullnetarët e Korpusit të Paqes.
- 1110** Të rinj dhe fëmijë u angazhuan në aktivitete dhe trajnime të ofruara në kampet verore.

Programet për grantet e vogla të vitit 2019

“World Connect bashkëpunon me Korpusin e Paqes në Shqipëri prej katër vitesh tashmë. Ne vlerësojmë jashtëzakonisht shumë njohuritë e mëdha që Vullnetarët e Korpusit të Paqes tregojnë për jetën e përditshme në Shqipëri dhe kujdesin dhe krenarinë që ndiejnë për komunitetet mirëpritëse dhe për homologët. Dhe ne kemi dëshmuar të njëjtin kujdes dhe njohuri te stafi i Korpusit të Paqes në Shqipëri, që ndajnë përvojën e tyre, aftësitë, njohuritë dhe kulturën me ne dhe partnerët tanë. Është një partneritet me përftime reciproke në kuptimin më të mirë dhe ne jemi lumtur të vazhdojmë rrugën përpara”

Patrick, Drejtori i Programit të World Connect



Programi i Partneritetit të Korpusit të Paqes PPKP lidh vullnetarët me komunitetet e tyre dhe sektorin privat në SHBA dhe në të gjithë botën, për të financuar projektet e iniciuara dhe drejtuara në komunitete.

\$21,012

Iu dhanë Korpusit të Paqes Shqipëri në vitin 2019 duke financuar kështu 8 projekte në 8 komunitete.

Donatorët që kontribuojnë nëpërmjet PPKP-së

“World Connect” është një organizatë që mbështet idetë novatore dhe zgjidhjet lokale për sfidat me të cilat përballen gratë dhe fëmijët në komunitete ku VKP-të nuk shërbejnë në të gjithë botën.

“Friends of Albania” (Miq të Shqipërisë) është një organizatë e krijuar nga Vullnetarët e kthyer të Korpusit të Paqes, që ofrojnë asistencë për komunitetet ku shërbejnë vullnetarët aktualë të Korpusit të Paqes.

“Water Charity” është një organizatë jo-fitimprurëse e përkushtuar të ndihmojë njerëzit të kenë akses në ujë të pijshëm dhe të pastër dhe kushte sanitare të përmirësuara.

Iniciativa e Zhvillimit Botëror dhe Mirëqenies së Grave (W-GDP) është një përpjekje qeveritare për të fuqizuar gratë në të gjithë botën që të realizojnë potencialin e tyre ekonomik, dhe duke bërë këtë të krijojnë kushte për qëndrueshmërinë dhe mirëqenien.

Asistenca e Projekteve të Vogla (APV)

PËRMBLEDHJE

194

•Totali i projekteve të financuara dhe zbatuara në Shqipëri që nga nisja e programit në 2004-ën.

\$2,000–\$4,000

•Gama e financimeve të disponueshme për projektin nëpërmjet granteve të APV-së

25%

•Sasia e fondeve të kërkuara si kontribut nga komuniteti

Në 2019

\$20,690

• Shuma u sigurua nga: USAID/Albania për aktivitetet APV

4

•Projektet e shkallës së ulët të financuara për komunitetin

3

•Hartimi i projektit dhe menaxhimi i workshop-eve të financuara nga VKP dhe homologët

Shtrirja e ndikimit: Organizatat partnere

Organizata jo qeveritare (OJQ)

- Agro-Puka
- Fondacioni i Zhvillimit të Kapaciteteve Vendore Shqiptare
- Këshillat Amerikanë
- Qendra ARKA-Shkodër
- CSDC Durrës
- Darien Book Aid
- Shoqata e mësuesve të gjuhës angleze
- UAF-Unioni i anglisht-folësve
- Fondacioni Food Bank Albania
- Friends of Albania
- Mary Ward Loreto
- New Bridges
- Qendra Marrëdhënie
- Agjencia e Zhvillimit Rajonal-Korçë
- Sidi Education
- Terre des Hommes
- Touristic Dibra
- Water Charity
- World Association of Girl Guides and Girl Scouts
- World Central Kitchen
- World Connect
- World Vision
- Qendra rinore —Vlorë

Bashkitë

- | | | |
|---------------|------------|----------------|
| • Berat | • Kavajë | • Lushnje |
| • Bulqizë | • Klos | • Mirditë |
| • Elbasan | • Korçë | • Përmet |
| • Ersekë | • Krujë | • Roskovec |
| • Fushë Arrëz | • Kuçovë | • Shijak |
| • Gjirokastrë | • Librazhd | • Ura Vajguore |

Government and Independent Organizations

- Kryqi i Kuq shqiptar
- ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar r)
- DPAP (Drejtoria e Përgjithshme i e Arsimit Para-universitar)
- HAP (Projekti Shëndet për të Gjithë)
- Instituti i Shëndetit Publik
- Ministria e Arsimit e Malit të Zi
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri
- Projekti për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore
- QSHA (Qendra për Shërbimet Arsimore)
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
- (USAID)
- Ambasada e Shteteve të Bashkuara dhe American Corners
- Universiteti i Shkodrës, departamenti i anglishtes
- Universiteti i Tiranës, departamenti i anglishtes

Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe Zyrat e Arsimit

- | | | |
|----------|-----------|-----------|
| • Berat | • Lezhë | • Tropojë |
| • Durrës | • Lushnjë | • Përmet |
| • Fier | • Mat | |
| • Kajave | • Shkoder | |
| • Korçë | • Skrapar | |

Trajnimi i stafit tonë para-shërbimit në vitin 2019

Çdo vit, Korpusi i Paqes Shqipëri punëson 18 pjesëtarë stafi të përkohshëm që luajnë një rol thelbësor në trajnimin para-shërbimit (TPSH) të të trajnuarve tanë. Këta individë janë po aq të përkushtuar ndaj idealeve dhe misionit të Korpusit të Paqes sa vetë stafi jonë i përhershëm. Ata janë pjesë e familjes sonë çdo vit dhe kur TPSH mbaron është e vështirë t'i themi mirupafshim. Ata i mësojnë të trajnuarve tonë një gjuhë e kulturë të re, aftësi teknike, si të jenë të sigurt dhe të shëndetshëm dhe i përgatisin për dy vitet e tyre të shërbimit si vullnetarë të Korpusit të Paqes. Korpusi i Paqes në Shqipëri është ky që është sot falë përpjekjeve të tyre.



Ali Gjiriti
Alketa Canka
Besarta Stafa
Besmira Rrumbullaku
Bruna Çoku
Denisa Panxhi
Eglantina Reka
Elona Pajova
Erion Kumuria
Ervin Bebeti
Imelda Celibashi
Ledion Veshi
Sara Gaçe
Vjollca Merdani
Xheni Hatillari
Ymer Leksi
Zamir Mero
Zerina Zeneli

Stafi ynë me kohë të plotë në vitin 2019

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mal i Ziështë krenar që ka një staf të përkushtuar të përbërë nga amerikanë, shqiptarë dhe malazezë. Ekipi ynë përbëhet nga disa prej talenteve më të mira në të dyja vendet ku shërbejmë. Ekipi e ka fokusin të ndihmojë vullnetarët të arrijnë potencialin e tyre gjatë shërbimit. Ata janë të emocionuar për punën e tyre dhe që do të bëjnë diferencën për fëmijët, komunitetet dhe njerëzit në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ky ekip është shembull për Korpusin e Paqes dhe vlerat që ne promovojmë. Ky është ekipi që është përgjegjës për punën e mirë që kemi bërë në Shqipëri që nga viti 1992, por gjithashtu edhe ekipi që iu kërkua të drejtonte dhe menaxhonte mundësinë e re për të shërbyer në Mal të Zi.

Agim Dyrmishi
Alsida Myrtaj
Arben Cako
Arben Loci
Ardijan Cobaj
Besa Arapi
Carmen Sheehan
Darina Kaltani
Diana Djaloshi
Dritan Kamberi
Elsona Cupi
Gentian Leka
Gentian Mano
Geri Martiri
Ilir Memlikaj
Ilir Ziu
Iris Dollia
Iva Sinani
Ivana Delibasic

Julian Pando
Kate Becker
Kyle Olsen
Luka Bobicic
Lumturi Piciri
Marie Aughenbaugh
Marjeta Zavalani
Marsela Loci
Mira Luca
Mirela Tahiraj
Monika Mukja
Poleta Luga
Qazim Hoxha
Sara Gaçe
Ylli Cupi





- Korpusi i Paqes në Shqipëri Rr. Besnik Sykja, Ndërtesa 2 Apartamenti 1, Kutia postare 8180 Tiranë, Shqipëri
- Zyra e Korpusit të Paqes në Mal të Zi Vaka Đurovića bb, Podgorica, Mal i Zi
- Telefoni: +355 +35542365
- Email: AL-information@peacecorps.gov
- Faqja e internetit:
- peacecorps.gov/albania/
peacecorps.gov/montenegro/
- Facebook:
- facebook.com/albania.peacecorps
facebook.com/peacecorpsinmontenegro
- Instagram:
- na kërkoni me emrin [@peacecorpsalbania](https://www.instagram.com/peacecorpsalbania)